



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit

01 Nr 462/01-52522 dt. 20 10 2023

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1, pika (h) të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72, të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12, nenit 40, lidhur me nenin 17, të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 11, të Ligjit Nr. 06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 23, paragrafi 7, të Rregullores (QRK) Nr. 06/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Raportit Nr.01-052-43818, të datës 31.08.2023, të Komisionit për vlerësimin e ofertave dhe rekomandimit të tij, Kuvendi i Komunës së Glllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë _____2023, të aprovojë këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë për 99 vite, Pronën e Paluajtshme të Komunës, me Procedurë të Negocimit të Ofertës

1. Me këtë Propozim Vendim, propozohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, prona e paluajtshme e Komunës, kompanisë “Frida’s Farm”, me numër unik identifikues 811978660, të cilën e përfaqëson Nicole Kuerten, me procedurën e negocimit të ofertës.
2. Prona e paluajtshme që propozohet për dhënie në shfrytëzim, sipas pikës 1 të këtij propozim vendimi, është pjesa e parcelës kadastrale P-70314017-00077-0, sipërfaqja 26950 metra katror, ndërsa nga parcela kadastrale P-70314067-00295-15, sipërfaqja 173050, metra katror, total sipërfaqja që do të jepet në shfrytëzim është 200000 metra katror, Zona Kadastrale Fushticë e Epërme gjejgjisht Sankoc, të dyja parcelat “klasa e pestë”.
 - 2.1. Parcializimi sipas pikës 2, të këtij propozimvendimi, do të bëhet në pajtim me vendimin e Kuvendit të Komunës, nr. 02-400/01-48439, me datë 27.9.2023.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, sipas pikës 1 të këtij propozim vendimi është: Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe përmbushja e interesit të përgjithshëm të qytetarëve.
 - 3.1 Në ofertën e negociuar “Frid’s Farm”, planifikon investim në realizimin e projektit “Ndërtimi i fermës për përpunimin e mishit të shpendëve”.

4. Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë në mes të kryetarit të komunës dhe kompanisë “Frida’s Farm”.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit në MAPL, si dhe 7 dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Kompania “Frida’s Farm”, me datë 20.07.2023 ka dorëzuar ofertën Nr.01-070/01-35280, pranë Komunës së Drenasit, respektivisht Kryetarit të Komunës, për marrje në shfrytëzim të pronës së komunës përmes Negocimit. Kuvendi i komunës me datë 27.08.2023 nxjerr vendimin Nr.02-020-36508 me anë të së cilit krijon komisionin, i cili do të ndihmojë dhe rekomandojë kryetarin e komunës në lidhje me vlerësimin e ofertave dhe kërkesave të pranuarra për dhënien e pronave me negociim. Ky komision, me datë 31.08.2023 bën Raportin nr.01-052-43818, me anë të së cilit i rekomandon Kryetarit të komunës vazhdimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, siç parashihet në nenin 2 të këtij propozim vendimi.

Kryetari i komunës me datë 20.10.2023, sipas procesverbalit nr.01-060/04-52241 negocion ofertën e kompanisë, ndërsa përmes këtij propozim vendimi i propozon kuvendit të komunës që duke pasur parasysh interesin e përgjithshëm dhe zhvillimin ekonomike të komunës se Drenasit të votohet ky propozim vendim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës



02Nr020-36908 dt. 27.07.2023

Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Nenit 11, paragrafi 2, të Ligjit nr. 06/1-092 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 72 paragrafi 72.1 pika g, h, i dhe paragrafi 72.2 pika a, g, të Statutit të Komunës së Drenasit të datës 16.09.2008, me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në vendimarrje, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë: 27.7.2023, miratoi këtë:

VENDIM

Për krijimin e komisionit i cili do të ndihmojë dhe rekomandojë kryetarit të komunës në lidhje vlerësimin e kërkesave të pranuar për dhënie të pronave me negociim

Neni I

Kuvendi i Komunës së Drenasit miraton vendimin për krijimin e Komisionit i cili do të vlerësojë dhe rekomandojë kryetarit të komunës në lidhje me shqyrtimin e kërkesave të pranuar për dhënie të pronave me negociim.

Neni II

Komisioni i formuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit ka në përbërje një anëtar nga Ekzekutivi, nga të gjitha subjektet e përfaqësuara në Kuvendin Komunal të Drenasit dhe një anëtar nga shoqëria civile:

1. Arben Shala- anëtar i komisionit nga Ekzekutivi
2. Bekim Lestrani nga PDK
3. Albulena Saluku nga PDK
4. Hamit Haxhiu nga DD
5. Florenatina Elezi nga LVV
6. Egzon Qorri nga LDK
7. Beqir Kiqina nga AAK
8. Arbër Halilaj nga Green
9. Kadire Tahiraj nga Shoqëria Civile

Neni III

Me këtë vendim komisioni që të bëjë shqyrtimin e kërkesave për dhënie të pronave me negociim dhe harton raportin me rekomandim të cilin ia përcjell kryetarit, e të cilin kryetari ia sjell kuvendit për aprovim.

Neni IV

Komisioni ka mandat deri në një vendim tjetër.

Neni V

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web-faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari

Arsyetim

Me qëllim që procesi të shkojë sa më mirë dhe me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në vendimmarrje Kryetari i Komunës së Drenasit ka vendosur që të paraqesë një propozim vendim për krijimin e një komisioni përmes të cilit të gjitha subjektet e përfaqësuara në kuvend do të kenë mundësi të jenë të informuar në detaje në lidhje me procesin e negocimit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit



Opština Gllgovc / Municipality of Drenas / Gllgovc
Komisioni për ndihmë dhe rekomandime për Kryetarin e Komunës në
lidhje vlerësimin e kërkesave të pranuar për dhënie të pronave me
negocim

01 Nr. 052-43818 dt. 31.08.2023

DATË: 16.08.2023

PËR: Kryetarin e Komunës së Drenasit
z. Ramiz Lladrovci

CC:

NGA:



TEMA:

Raport i takimit të komisionit i cili do të ndihmojë dhe
rekomandojë Kryetarit të Komunës në lidhje vlerësimin e
kërkesave të pranuar për dhënie të pronave me negocim

Kronologji e shkurtër:

Me propozim të kryetarit të Komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci, kuvendi në mbledhjen e mbajtur më datë 27.07.2023, ka nxjerrë vendimin me nr. Protokolli 02 nr. 020-36908, për krijimin e komisionit i cili do të ndihmojë dhe rekomandojë Kryetarit të Komunës në lidhje vlerësimin e kërkesave të pranuar për dhënie të pronave me negocim.

Komisioni ka këtë përbërje: Arben Shala, Bekim Lestrani, Albulena Saliuku, Hamit Haxhiu, Florentina Elezi, Egzon Qorri, Beqir Kiqina, Arbër Halilaj dhe Kadire Tahiraj.

Më datë 01.08.2023, anëtari i komisionit nga ekzekutivi, Arben Shala ka dërguar email me përmbledhjet e kërkesave të pranuar për negocim.

Në po të njëjtën datë është krijuar një grup në WhatsApp me përbërjen e shumicës së komisionit, por jo të gjithë pasi që numrat e disa prej anëtarëve të komisionit nuk kanë rezultuar të kenë WhatsApp.

Me datë 04.08.2023, është dërguar email i ri me ftesën për takim me datën 07.08.2023. Të dielën më 06.08.2023, anëtarja e Komisionit nga LVV Florentina Elezi ka konfirmuar mospjesëmarrjen e saj në mbledhje të komisionit.

Më datën 07.08.2023, në ora 10.20, Komisioni në përbërje të Arbën Shalës, Bekim Lestrani, Albulena Saliukut, Hamit Haxhiut dhe Beqir Kiqinës është mbledhur në sallën e bordit kanë filluar mbledhjen dhe kanë diskutuar për kërkesat e pranuar si më poshtë:

1. Kërkesa nga TDI Balkans për dhënie në shfrytëzim të tri ngastrave me sipërfaqe të përgjithshme prej 56 ha në Komoran dy për vendosjen e paneleve solare në kohëzgjatje të papërcaktuar në kërkesë.
 1. Vlera e investimit: afërsisht 29.5 milion EURO,
 2. Numri i të punësuarve nga investimi: gjatë periudhë së ndërtimit mbi 20 persona dhe pas ndërtimit 2 - 4 persona,
 3. Lloji i investimit që është më interes publik me prioritet për komunën: Prodhim i energjisë së pastër, të ripërtëritshme nga panelet solare,
 4. Përfitimi financiar dhe ekonomik i komunës: 1,000,00 €/MW në vit (njëmijë euro për megavat në një vit kalendarik).
 5. Plani investiv për projektin Komoran #1: 42.5MW - 45 MW x 1,000.00 € = 42,500.00 € - 45,000.00 € në vit.
 6. Duke filluar nga periudha e pagesës së parë të qirasë, shuma e pagesës së qirasë do të valorizohet çdo vit sipas indeksit të rritjes së çmimeve për mallrat dhe shërbimet e konsumit (i ashtuquajtur i Indeksi i inflacionit) të publikuar nga ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës për çdo vit para indeksimit në: <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-ofstatistics/economy/prices>. Një valorizim të tillë do të merret parasysh sapo i njëjti të shpallet.

2. Kërkesa nga Frida's Farm për dhënie në shfrytëzim me qira të një ngastre prej 20 hektarësh e me mundësi zgjerimi edhe me 40-50 hektarë pas vitit të 5^{të} të funksionimit.
 1. Vlera e investimit 8.9 milion euro
 2. Punëtorë me faza si në vijim
 - Faza e Ndërtimit plus 40-50 nga Drenasi me rrethinë / 2 vite
 - Faza e operimit, plus 60-70 nga Drenasi dhe rrethina, operimi i plotë
 - Faza e Administrimit dhe shpërndarja plus 30 nga Drenasi dhe rrethina, operimi i plotë
 - Faza e zgjerimit të kompanisë plus 20, viti 5
 - Faza e Kompanisë së Re për Bio Bujqësi duke filluar nga Faza 1 nga viti 5
 3. Kërkesa për qira përfshin tri opsione:
 - 5 vitet e para pa qira ose taksë pas kësaj kohe 0,5 % pas EBIT

Ose

 - Pas përfundimit të ndërtimit 319 Euro për Hektar (çmimi i njëjtë si në Gjermani për tokën bujqësore)

Ose

 - Mbështetja për komunën së Drenasit me sponsorizim kulturor apo sportiv me një shumë rreth 10.000 euro në vit.

Konkluzionet:

Komisioni nxori konkluzionet e mëposhtme:

1. TDI Balkans
 - Sipërfaqja e përlogaritur për të tri parcelat është 56 ha.
 - Është tokë e klasit të 6-të, për momentin e pashfrytëzuar.
 - Kjo nuk angazhon numër të madh të punëtorëve por përfitimi nga qiraja është i kënaqshëm për komunën, mbi 750 euro për hektar.
 - Në kërkesë kërkohet parcela P – 70314035-01317-0, përderisa në listën e lokacioneve të mundshme për investim në Komunën e Drenasit, kjo parcelë figuron me numrin P – 70314035-01317-1. Kërkohet që të kihet vëmendje për këtë çështje dhe të përmirësohet.

Në mënyrë unanime komisioni rekomandoi që kërkesa e lartpërmendur nga TDI të merret në konsideratë pozitivisht, respektivisht të aprovohet kërkesa e tyre duke marrë parasysh çështjet e lartpërmendura.

2. Frida's Farm

- Sipërfaqja fillestare e kërkuar është 20ha me mundësi zgjerimi edhe për 40-50 të tjera.
- Me këtë përfitimi i komunës është në numrin e të punësuarve, përderisa sa i përket pagesës për shfrytëzim të pronës, komisioni aprovoi opsionin e dytë për qira vjetore prej 319 euro në vit.
- Komisioni tërheq vëmendjen se pas 20 ha të parë mund të ketë vështirësi në sigurimin e hektarëve tjerë pasi që nëse në ndërkohë vjen një ofertë e kënaqshme, mund të jepen në shfrytëzim e jo të pritet pas vitit të 5 që Frida's Farm e kërkon.

Në mënyrë unanime komisioni rekomandoi që kërkesa e lartpërmendur nga Frida's Farm të merret në konsideratë pozitivisht, respektivisht të aprovohet kërkesa e tyre duke marrë parasysh çështjet e lartpërmendura.

Takimi ka përfunduar në ora 11.40.

Komisioni në përbërje të:

Arben Shala
Bekim Lestrani
Albulena Saliuku
Hamit Haxhiu
Florentina Elezi
Egzon Qorri
Beqir Kiqina
Arbër Halilaj
Kadire Tahiraj



The image shows a circular official stamp of the Municipality of Glogoc, Republic of Kosovo. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E KOSOVOS' at the top, 'KOMUNA E GLOGOCIT' at the bottom, and 'REPUBLIC OF KOSOVO - MUNICIPALITY - KOMUNA E GLOGOCIT' around the perimeter. In the center is a blue eagle emblem. Overlaid on the stamp are several handwritten signatures in blue ink, each followed by a horizontal line.

Kopje për:

Kryetarin Ramiz Lladrovci
Sekretarisë së Kuvendit
Të gjithë anëtarëve të komisionit



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01- Nr 060/04 52241 dt. 20 10 2023

PROCESVERBAL

I takimit të kryetarit të komunës z. Ramiz Lladrovci dhe përfaqësuesit të kompanisë "Frida's Farm", znj. Nicole Kuerten

Takimi filloi në ora: 14:45

Lidhur me çështjen e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim përmes negociimit me qëllim të investimit ashtu siç parashihet në Ligjin Nr.06/L-092 mbi Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, sipas ofertës së kompanisë "Frida's Farm", si dhe rekomandimeve të Komisionit të datës 16.8.2023, u negociua oferta me pikat kryesore të saj si në vijim, të cilat më gjerësisht janë paraparë në planin ideor për investim:

- Sipërfaqja për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim: 20 hektarë, sipas zhvillimit planifikohet të shtohet sipërfaqja deri në 40-50 hektarë.
- Afati i qirasë: 99 vjet
- Vlera e investimit: 8.9 milion euro
- Qiraja për hektar: 319 euro (çmim i njëjtë me qiranë në Gjermani)
- Punësimi me prodhim mesatar, pas 4 deri 5 vjetëve: 160 persona
- Punësimi i punëtorëve deri në fillimin e prodhimit: 50-60 punëtorë
- Pagesa e qirasë fillon nga dita e fillimit të prodhimit (2-3 vjet)
- Mbështetja për komunën së Drenasit me sponsorizim kulturor apo sportiv me 10.000 euro në vit.
- Qiraja do të valorizohet çdo vit sipas indeksit të rritjes së çmimeve për mallrat dhe shërbimet e konsumit (Indeksi i inflacionit) të publikuar nga ASK, në: <https://ask.rks-gov.net/en-kosovo-agency-of-statistics/economy-prices>. Një valorizim i tillë do të merret parasysh sapo i njëjti të shpallet.

U dakordua shikimi i vendit, të ruhet distanca nga Stadiumi nacional, nëse nuk është distancë e përshtatshme, komuna do të ofrojë zgjidhje tjetër të pranueshme nga investitori.

Takimi ka përfunduar në ora: 15:30

Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

Procesmbajtëse
Dijelza Berisha

Investitori "Frida's Farm"





Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr.400/01-48439 dt. 27/09/ 2023



Bazuar në nenin 11,12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 34 Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 9 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 27.09.2023, miratoi këtë:

V E N D I M
Për ndarjen e parcelave kadastrale

Neni 1

Me këtë vendim, kërkohet miratimi i ndarjes së parcelave kadastrale 295-15 dhe 300-0 të cilat ndodhen në Sankoc dhe parcelën 77-0 e cila ndodhet në Fushticë të Epërme, të cilat janë paraparë që të ipen në shfrytëzim sipas procedurave të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Neni 2

Parcelat që kërkohen të ndahen, janë si më poshtë:

1. Parcela kadastrale 295-15 zona kadastrale Sankoc
2. Parcela kadastrale 300-0, zona kadastrale Sankoc
3. Parcela kadastrale 77-0, zona kadastrale Fushticë e Epërm

Neni 3

Ndarja e parcelave kadastrale 295-15 dhe 300-0 në Zonën Kadastrale në Sankoc dhe parcela 77-0 në zonën kadastrale Fushticë e Epërme, bëhet duke pasur parasysh interesin ekonomik të Komunës së Drenasit, Planin Zhvillimor Komunal, dhe Planin Rregullues Urban Komunal, Hartat Zonale Komunale.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtroia për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Milaim Hajdari

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit

ARSYETIM

Ndarja e parcelave kadastrale 295-15 dhe 300-0 në zonën kadastrale në Sankoc edhe parcela kadastrale 77-0 në zonën kadastrale në Fushticë të Epërme, bëhet duke pasur parasysh interesin ekonomik të komunës së Drenasit, Planin Zhvillimor Komunal, dhe Planin Rregullues Urban Komunal.

Andaj, duke u bazuar në nenin 9 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës përcaktohet se për Rregullimin e pronës nga komuna duhet ndjekur procedurat e nevojshme ligjore, duke marr vendim Kuvendi i Komunës.

Bashkangjitur gjeni:

- Skicat e parcelave të propozuara për ndarje.
- Fletët poseduese të parcelave të cekura më lartë.



Republika e Kosovës

Republica Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70314017-00077-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

07-942-52360

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

20.10.2023 - 15:05

Komuna / Opština / Municipality:

GLLOGOC / GLOGOVAC / GLOGOC

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Fushicë E Epërme / Gorja Fušica / Fushicë E Epërme

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

GLLOGOC / GLOGOVAC / GLOGOC

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70314017-00077-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Rural	753996			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS


Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
GOLESH-GOLESH				

A.2 LLOJI I SHRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Breg Number	Kloji i shrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelë Parcel Type Of Use	Shrytëzimi aktual i parcelës Trenutna koriscenje parcelë Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet Klasse Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Površina Area (m ²)
1	Bujqësore/Poljoprivredna/Agriculture	Kullosat/Pashnjaci/pasture	Kullosë E Klasës 5/Pashnjak 5 Klasse/5th Class Pasture	753996

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licent broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Toglednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Poseidim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Glllogocit	600316708	GILLOGOC / GILGOVAC / GILLOGOC /		FEHMI DHE XHEVË LLADROVCI	1/1		





REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVES / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MEDIT, PLANIFIKIMIT HAPESINOR DHE INFRASTRUKTURES
MINISTARSTVO ZIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGENCIA KADASTRALE E KOSOVES / KATASTARSKA AGENCIA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komune/ Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office : GLOGOC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Fushitë E Epërme

Njësia/Jednica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Površina/Area m ²
P-70314017-00077-0	Parcelë / Parcela / Parcel	753996



Shkalla/Razmera/Scale: 1:10266

Shënim/Beleška/Note:

Nënskrimi/Polpis/Signature:

Koha/Vreme/Time: 03:08:38


Data/Date: 20.10.2023

Punë/Obradio/Created:

Nënskrimi/Polpis/Signature:

Drejton/Direktor/Director

Approv/Usvojio/Approv



Handwritten signature of the Director

Handwritten signature of the Approver



Republika e Kosovës

Republica Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedietit, Planifikimit, Hapësirave dhe Infrastrukturës / Ministrstvo Zivane Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastruktura /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NIËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70314067-00295-15

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 07-942-52360

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 20.10.2023 - 15:04

Komuna / Opština / Municipality: GILLOGOC / GLOGOVAC / GILLOGOC

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Sankoc / Slankovce / Sankoc

Zyra kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: GILLOGOC / GLOGOVAC / GILLOGOC

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i afësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësive Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronisë Vrsta imovine Property Type	Zona UR G/S UR	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më daten Urađeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-70314067-00295-15	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Rural	3145695	SIPAS KEREKESSE SE TERENIT ME NR. 07-952-37259 ME DT. 16.07.2015	21.03.2022	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS


Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
GOLESH-GOLESH			21.03.2022	

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broy Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta korisçenja parcelë Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno korisçenje parcelë Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Površina (m ²) Area
1	Bujësi/Poljoprivredno/Agriculture	Kullorë/Pashjaç/pasture	Kullorë E Klasës 5/Pashjak 5 Klase/5th Class Pasture	3145695

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Pravi Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licent broj ID. No.	Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostni adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Pershtkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Gillogocit	600316708	GILLOGOC / GLOGOVAC / GILLOGOC /		FEHMI DHE XHEVË LLADROVCI	1/1		24.03.2022



REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVË / VLADE KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA


MINISTRIA E MËDITISË, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ZDROTHNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVË / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPJA PLANA / COPY PLAN


Zyra Kadastre Komune/Optinska Katarstarska Kancelarija / Municipal Cadstral Office : GLOGOC
Zona Kadastre / Katarstarska Zona / Cadstral Zone: Sankoc

Njësia/Jedimca/Unit	Parcelë / Parcela / Parcel	Sipërfaqja/Površina/Area m ²
P-70314067-00295-15		3145695



Puno/Obrador/Created:
 Data/Data/Date: 20.10.2023
 Koha/ Vreme/ Time: 03:07:33
 Nenshkrimi/Popis/Signature:
 Nenshimi/Beleska/Note:

Approv/Usvojto/Approved: _____
 Director/Direktor/Direktor
 Nenshkrimi/Popis/Signature: _____





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Nr-01- 463102 - 64701 dt. 19/12 /2022

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1, pika a dhe c të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 13 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 5 pika 1.3 dhe nenit 6 të Rregullores Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Komuna e Drenasit nxjerrë:

V E N D I M

Për publikimin e Listës së Përgjithshme të Pronave të Komunës së Drenasit, si dhe Listen e Veçantë të Pronave të Paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2023.

Neni 1

Me këtë vendim publikohet Lista e Përgjithshme e Pronave të Komunes së Drenasit e paraqitur në formë tabelare.

Neni 2

Pjesë e këtij vendimi është edhe Lista e Veçantë Pronave që planifikohen për t'u dhënë në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2023, e cila përfshin të dhënat kadastrale të pronave, lokacionin dhe destinimin e tyre me PZHK dhe Hartë Zonale, si dhe paraqitjen tabelare.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Për zbatimin e këtij Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

Vendimi i'u dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit
- Drejtorive Përkatëse
- Arkivit



Kryetari i Komunës
Ramiz Vladoçvi

A r s y e t i m

Komuna e Drenasit duke u bazuar në faktin se me dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës do të krijohen kushte për zhvillimin e bizneseve, krijimin e mundësisë për investime nga investitorët vendor dhe të huaj me ç'rast do të krijohen vende të reja të punës, dhe do të ndikohet në rritjen e zhvillimit ekonomik në komunë.

Me dhënien e pronës komunale në shfrytëzim sipas dispozitave ligjore në fuqi, Komuna do të inkason edhe të hyra komunale të cilat konsiderohen para publike dhe i nënshtrohen dispozitave ligjore për menaxhimin e financave publike.

Po ashtu Kuvendi i Komunës së Drenasit me datë 30.07.2020, ka miratuar Vendimin për Miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2020-2028, me të cilin është planifikuar zhvillimi ekonomik i Komunës së Drenasit, ku pjesë e këtij plani janë edhe pronat të cilat janë pjesë e Listës së Veçantë që planifikohen të ipen në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2023.

